

## Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur anëtarë të familjes,

Në këtë kapitull do të trajtojmë me zgjidhjen e ekuacioneve. Aftësia për të zgjidhur ekuacione jo vetëm është një nga më të rëndësishmet dhe më të përdorshmet në matematikë, por gjen edhe një numër të madh zbatimesh në shkencë, studimet shoqërore dhe jetën e përditshme. Kjo aftësi do të na ndihmojë të gjejmë, bie fjala, se për sa gallonë karburant do të kemi nevojë, nëse duhet të përshkojmë një distancë prej 500 miljesh. Shkencëtarëve që dërgojnë një satelit në hapësirë, ekonomistëve që bëjnë parashikime dhe qytetarëve që përgatitin deklaratën e taksave, u duhet të gjithëve të zgjidhin ekuacione komplekse.

Në klasat më të ulëta, jemi njohur me metoda të ndryshme për zgjidhjen e ekuacioneve. Në këtë kapitull do t'u kthehemi atyre metodave dhe do t'i zgjerojmë më tej, për të zgjidhur mosbarazimet dhe sistemet e dy ekuacioneve me dy të panjohura. Gjithashtu do të mësojmë si të përdorim makinat llogaritëse grafike për të gjetur zgjidhje të përafërta të ekuacioneve dhe të çifteve të ekuacioneve.

Në jetën e përditshme ndeshemi shpesh me mosbarazime. Për shembull, nëse ju keni vetëm 5 \$ me vete në dyqan dhe dëshironi të bleni lapsa që kushtojnë 1,95 \$ secili dhe fshirëse 0,59 \$ secila, atëherë mosbarazimi

$$1,95m + 0,59p \leq 5,00$$

tregon se çfarë kombinimesh lapsash dhe fshirësesh mund të bleni. Në shembullin në fjalë, mund të bleni 1 laps dhe 5 fshirëse ose 2 lapsa dhe 2 fshirëse.

Gjithashtu do të mësojmë të zgjidhim sisteme ekuacionesh me dy të panjohura. Në probleme të tilla, na duhet të gjejmë një çift vlerash që i kënaqin të dy ekuacionet. Për shembull:

Në një lojë basketbolli, Korina bëri 10 kosha, duke fituar gjithsej 23 pikë. Disa prej koshave ishin 2-pikësh, disa të tjerë 3-pikësh. Sa kosha 2-pikësh dhe sa kosha 3-pikësh bëri Korina?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet të ndërtojmë një sistem ekuacionesh si më poshtë, ku  $x$  shenjon numrin e koshave 2-pikësh, ndërsa  $y$  numrin e koshave 3-pikësh:

$$x + y = 10 \quad \text{dhe} \quad 2x + 3y = 23$$

**Fjalor** Gjatë kësaj kohe do të njihemi me termat e mëposhtëm:

**eliminim**  
**mosbarazim**

**zëvendësim**  
**sistem ekuacionesh**

### Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Kërkojini nxënësit t'ju tregojë disa prej ekuacioneve që po zgjidh, si dhe t'ju flasë për metodat që po përdor për t'i zgjidhur. Nxiteni nxënësin të mendojë se si mund të përdoren këto aftësi në situata jashtëshkollore.

